REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E DREJTËSISË

NDIHMA JURIDIKE | PRAVNA POMOĆ
LEGAL AID

"HERONJTË E PADUKSHËM"

Përmes aktivitetit "Heronjtë e padukshëm", Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) shpalos punën e zyrtareve të ANJF-së përmes intervistave me zyrtarët ligjor të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Njihuni me Qëndrim Gashi, zyrtar për ndihmë juridike falas, përmes intervistës së realizuar.

Qëndrim Gashi, ka qenë i përkushtuar që në fillim të karrierës së tij për të ofruar ndihmë juridike falas për individët dhe komunitetet që kanë nevojë. Duke u frymëzuar nga dëshira për të kontribuar në të mirën publike, ai u bë pjesë e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nëpërmjet programit të praktikës së USAID-it në vitin 2018.

Gjatë kohës së tij si praktikant, Qëndrimi u angazhua me përkushtim të lartë në shërbimin ndaj komunitetit. Ai trajtoi raste mjaft sfiduese, duke ofruar shërbime për individë që I përkasin grupeve të ndryshme etnike dhe kulturore. Falë bashkëpunimit me kolegët dhe mentorët e tij, ai zhvilloi aftësinë për të kuptuar dhe adresuar nevojat individuale të përfituesve të ndihmës juridike falas.

Me kalimin e kohës, Qëndrimi demonstroi përkushtim të jashtëzakonshëm në punën e tij, duke ndihmuar në rritjen e kapaciteteve të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Kështu, për një kohë të shkurtër arriti të punësohej si zyrtar i ndihmës juridike falas duke sjellë me vete në punën e tij vlerat dhe parimet që USAID promovon. Ai u bë një burim frymëzimi për kolegët e tij, duke shfaqur përkushtim, profesionalizëm dhe respekt ndaj palëve përfituese të ndihmës juridike falas.

Për Qëndrimin ndihma juridike falas është e domosdoshme për të siguruar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë. Ai thotë, "Në punën time, kam parë se sa shumë impakt mund të kemi kur jemi pranë personave që kanë nevojë për ndihmë juridike falas. Ne mund të ndryshojmë jetë dhe të sigurojmë drejtësi për ata që nuk kanë mundësi financiare të paguajnë për një avokat. Është një privilegj i madh të jem në gjendje të ofroj kontributin tim në këtë drejtim".

Me pasionin e tij për të kontribuar në të mirën të qytetarëve, Qëndrimi është frymëzim dhe inkurajim për gjeneratat e ardhshme që të ndjekin rrugën e tij, duke shërbyer me integritet dhe përkushtim për të siguruar drejtësi dhe ndihmë juridike falas për të gjithë ata që kanë nevojë.